



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 17.06.2019
(Dokument parlamentar)

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR SHËRBIMET
AJRORE**

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 17.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Sadi Vorpsi.

Për të bërë prezantimin e projektligjit në komision mori pjesë Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z.Artan Shkreli.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektaktit normativ***

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore, e cila ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror.

Republika e Shqipërisë, si nënshkruese e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, më 7 dhjetor 1947 (Konventa e Çikagos) ka detyrime të koordinojë veprimtarinë e saj në fushën e aviacionit civil. Bashkëpunimi në fushën e transportit ajror konsiston dhe orientohet nga parimi i krijimit të komunikimit ndërmjet vendeve, gjë e cila justifikon dhe iniciativën e nisur për të realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Marrëveshja, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore, u përafua në Tiranë, më 25 – 26 shkurt 2014, në takimin midis përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe përfaqësuesve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, më 6 shkurt 2019, në Riad.

Kjo marrëveshje do të ndikojë në krijimin e kushteve të përshtatshme, të ndërsjella dhe lehtësuese, për operatorët e transportit ajror të të dyja vendeve, si dhe kalimin tranzit nëpërmjet territoreve të tyre, me qëllim lëvizjen pa pengesa për shtetasit e të dyja palëve.

- ***Përfundime***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektakti i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektakti është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATORE

KRYETARE

SADI VORPSI

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)